

*D. A. Pasolomali*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

14 Shkurt 2021

KËRKESË

Drejtuar: z. Gramoz Ruçi  
Kryetar i Kuvendit

I nderuar Z. Ruçi,

Në mbështetje të nenit 81 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin time si deputete e Kuvendit të Shqipërisë, po ushtroj të drejtën e nismës ligjvënëse, duke depozituar në Kuvend projekt-ligjin "Për Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale" në Shqipëri, të shoqëruar nga relacioni shpjegues.

Projekt-ligji është përgatitur në bashkëpunim me një ndër organizatat kryesore të shoqërisë civile, CRCA Shqipëri, ndërkohë që është konsultuar me institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile përgjatë periudhës 1 Shtator – 31 Dhjetor 2020.

Sinqerisht,

*Fajza*  
*Mithi*  
Deputete



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_/2021

dt 04.02.2021

**“PËR REGJISTRIN KOMBËTAR TË TË DËNUARVE PËR KRIME SEKSUALE”**

Në mbështetje të neneve 54, 78, 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të një deputeti,

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

**Objekti**

Ky ligj ka për objekt krijimin e Regjistrit Kombëtar të të Dënuarëve për Krime Seksuale në Shqipëri.

Neni 2

**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim:

- a) parandalimin e ngacimit, dhunës, abuzimit apo shfrytëzimit seksual të çdo individi që jeton në Republikën e Shqipërisë;
- b) përcaktimin e rregullave për ngritjen dhe funksionimin e Regjistrit Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale në Shqipëri;

- c) caktimin e përgjegjësive për autoritetet përgjegjëse, autoritetet e tjera dhe çdo institucion apo organizatë publike ose private, që punon me / për fëmijët;
- d) marrjen e masave për regjistrimin në Regjistër të të gjithë të dënuarëve me vendim gjykate të formës së prerë për krime seksuale;
- e) rregullimin e lëvizjes dhe veprimeve të të dënuarëve duke kufizuar kontaktin fizik apo virtual të personave të regjistruar në Regjistër me viktimat e mundshme të krimeve seksuale;

### Neni 3

#### Përkufizimet

Në këtë ligj termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. "Autoritet përgjegjës" është organi ose institucioni shtetëror, strukturat në nivel qendror a vendor, i cili/të cilat, brenda fushës së veprimtarisë së tij/tyre, harton/një politika dhe ushtron/jnë përgjegjësitë e regjistrimit, mbajtjes, ruajtjes dhe trajtimit të të dhënave të të dënuarve për krime seksuale.
2. "Baza e të dhënave" nënkupton sistemin e të dhënave që siguron ruajtjen e plotë në formë fizike dhe elektronike të të dhënave të regjistruara për personat e dënuar për krime seksuale në këtë Regjister.
3. "Fëmijë" është çdo person nën moshën 18 vjeç, sipas parashikimeve të ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.
4. "I dënuar për krime seksuale" konsiderohet çdo person i cili është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për një ose disa nga veprat penale të parashikuara nga nenet 100; 101; 102; 102/a; 103; 104; 105; 106; 107/a; 108; 108/a; 121/a dhe 128/b të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
5. "Pedofil" është personi që abuzon seksualisht me fëmijët, pavarësisht nga gjinia e tyre.
6. "Person që rregjistron" është personi i autorizuar të regjistrojë informacione sipas këtij ligji.
7. "Personi më i afërt" është bashkëshorti, njëri prej prindërve, fëmija, vëllai, motra ose ndonjë person tjetër që e përcakton vullnetarisht personi i dënuar për krime seksuale gjatë regjistrimit të tij në Regjister.
8. "Përbërës të regjistrimit" janë të gjitha elementet e përcaktuara në këtë ligj, që shërbejnë për përcaktimin e identitetit të personave të dënuar për krime seksuale.
9. "Predator seksual" është grabitçari seksual që kryen një prej veprave penale të parashikuara në këtë ligj.
10. "Regjistri" në kuptim të këtij ligji do të konsiderohet Regjistri Kombëtar i të Dënuarve për Krime Seksuale.
11. "Të dhëna personale" është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshem, direkt ose indirekt, në veçanti, duke i'u referuar një numri identifikimi ose një apo më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor, apo social.
12. "Pikë kontakti më e afërt me policinë" është zyra më e afërt e policisë në zonën në të cilën banon personi i regjistruar.

#### Neni 4

#### Fusha e zbatimit dhe subjektet

1. Ky ligj zbatohet për çdo person me shtetësi shqiptare, me shtetësi të huaj ose pa shtetësi, i cili ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë që është dënuar me një vendim të formës së prerë në gjykatat e vendit ose një gjykatë e huaj për vepra penale në fushën seksuale.
2. Ky ligj zbatohet edhe për personat e dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për krime seksuale përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, për aq kohë sa vepra penale e kryer prej tyre nuk është parashkruar.

#### KREU II

#### PARIMET THEMELORE

#### Neni 5

#### Parime të përgjithshme

Ky ligj respekton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parashikuara në Kushtetutën e Shqipërisë dhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe aktet e tjera për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të OKB-së dhe KEDNJ-së.

#### Neni 6

#### Mbrojtja e interesit më i lartë të fëmijës

Të gjitha autoritetet përgjegjëse, institucionet publike dhe private, apo personat që për shkak të marrëdhënieve të punës sipas këtij ligji kanë akses në Regjister, në çdo vendim dhe veprimtari të ndërmarrë në zbatim të këtij ligji, duhet të vlerësojnë dhe zbatojnë me përparësi mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

#### Neni 7

#### Parimi i mbrojtjes së konfidencialitetit

1. Të dhënat personale të personave të regjistruar në Regjister konsiderohen të dhëna konfidenciale dhe trajtohen në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Aksesit në Regjister, administrimi, përdorimi dhe transmetimi i të dhënave që ndodhen në Regjister janë të kufizuara, ato mbrohen dhe administrohen sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore përkatëse.

#### Neni 8

#### Parimi i mbrojtjes së të dhënave personale

1. Autoriteti përgjegjës, institucioni publik ose privat, si dhe çdo person që për shkak të marrëdhënieve të punës ka akses në Regjistër, ka detyrimin që gjatë përpunimit të të dhënave personale apo të të dhënave që lidhen me Regjistrin, të zbatojnë Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Detyrimi për mbrojtjen, ruajtjen, mos-përhapjen, mbi të gjithë personat që për shkak të marrëdhënieve të punës kanë qasje në Regjister, shtrihet gjatë dhe pas mbarimit të ushtrimit të detyrës.

#### Neni 9

##### **Parimi i vërtetësisë dhe objektivitetit**

1. Autoritetet përgjegjëse kanë detyrimin që gjatë veprimtarisë së tyre të mbledhin dhe regjistrojnë me vërtetësi dhe korrektësi informacionet dhe të dhënat që shënohen në Regjister, si dhe t'i transmetojnë të dhënat në mënyrë të qartë tek subjektet që sipas këtij ligji kanë në Regjister.
2. Në rast të regjistrimit ose transmetimit të informacioneve të pasakta, autoritetet përgjegjëse marrin masa për korrigjimin e tyre.

#### Neni 10

##### **Parimi i përgjegjësisë**

1. Autoriteti përgjegjës, institucioni publik ose privat, si dhe çdo person që për shkak të marrëdhënieve të punës ka akses në Regjister, për çdo vendim ose veprimtari të ndërmarrë në zbatim të këtij ligji, ka detyrim të ushtrojë me korrektësi kompetencat, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e personit të regjistruar.
2. Secili mban përgjegjësi për dëmet që mund të shkaktojë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### KREU III

#### MEKANIZMAT INSTITUCIONALË PËR ZBATIMIN E LIGJIT

#### Neni 11

##### **Autoriteti përgjegjës**

1. Autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Ajo krijon dhe mirëmban Regjistrin si bazë e të dhënave, ku pasqyrohen të dhënat e personit të dënuar për krime seksuale.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është autoriteti përgjegjës për mbledhjen, përpunimin dhe korrigjimin e të dhënave dhe regjistrimin e personave të dënuar për krime seksuale në Regjister.

#### Neni 12

##### **Detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është përgjegjëse për krijimin dhe marrjen e masave me qëllim ruajtjen e Regjistrit dhe zbatimin e këtij ligji.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka detyrë të:
  - a) menaxhojë dhe mirëmbajë bazën e të dhënave në Regjister.
  - b) të administrojnë standardet për regjistrimin dhe njoftimin e të dënuarëve për krime seksuale të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore;
  - c) caktojë në çdo Drejtori Rajonale dhe Vendore të Policisë, pikën e kontaktit më të afërt me policinë;
  - d) të japë informacionet e nevojshme që i kërkohen institucioneve publike dhe private që punojnë me / për fëmijët dhe që sipas ligjit kanë për detyrë të mbrojnë fëmijët nga grabitqaret seksual;
  - e) të njoftojë dhe të japë paraprakisht informacionet e nevojshme strukturave homologe të policisë së shtetit përkatës, kur personi udhëton nga një shtet në tjetrin, në mënyrë që të merren masa në kohë që personi të mos ketë mundësi kontakti me fëmijët apo me viktimat potenciale të krimeve seksuale. E njëjta procedurë ndiqet edhe për levizjet e brendshme të personit;
  - f) të kryejnë përpjekje serioze për të identifikuar dhe mbështetur viktimat e krimeve seksuale;
  - f) të bashkëpunojë me organet shtetërore për parandalimin ose përsëritjen e krimeve seksuale ndaj të njëjtëve viktimas nga personat e dënuar për krime seksuale;
  - g) të lidhë marrëveshje/memorandume bashkëpunimi me institucionet publike dhe private që punojnë me / për fëmijët dhe që sipas ligjit kanë për detyrë të mbrojnë fëmijët si dhe me institucionet përgjegjëse homologe në shtetet e huaja.

#### Neni 13

##### **Ndërtimi dhe menaxhimi i faqes së internetit**

1. Për funksionimin e Regjistrit dhe zbatimin sa më efikas të këtij ligji ndërtohet një faqe zyrtare në internet, nën titullin Rregjistri Kombëtar i të Dënuarëve për Krime Seksuale.
2. Krijimi, menaxhimi dhe disponueshmëria e faqes zyrtare në internet për Regjistrin është kompetencë dhe detyrë e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

#### Neni 14

### **Raportimi**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nëpërmjet përfaqësuesve të tyre ligjore paraqesin një raport të përbashkët një herë në vit përpara komisionit parlamentar përgjegjës të Kuvendit të Shqipërisë. Një kopje e këtij raportimi i dërgohet Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.
2. Raporti vjetor për vitin pasardhës duhet të paraqitet jo më vonë se 30 prilli i vitit në vazhdim.

### **Neni 15**

#### **Institucione të tjera përgjegjëse**

Ministria e Brendshme cakton me akt nënligjor në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, autoritetin përgjegjës që krijon, mirëmban dhe menaxhon Regjistrin.

### **Neni 16**

Ministria e Drejtësisë cakton me akt nënligjor në çdo Institucion të Ekzekutimit të Vendimeve Penale të Republikës së Shqipërisë, autoritetin përgjegjës për informimin e DPPSh lidhur me përfundimin e vuajtjes së dënimit për personat e dënuar për krime seksuale.

### **Neni 17**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Mirëqënies Sociale hartojnë programe të posaçme për trajtimin, integrimin dhe rehabilitimin shëndetsor, social, moral dhe ekonomik të personave të dënuar për krime seksuale gjatë dhe pas vuajtjes së dënimit.

### **Neni 18**

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë është përgjegjëse për monitorimin, kontrollin dhe sigurimin e zbatimit të këtij ligji nga institucionet publike dhe jopublike të arsimit parauniversitar.

## **KREU IV**

### **PËRMBAJTJA E REGJISTRIT**

### **Neni 19**

#### **Përmbajtja e Regjistrit kombëtar**

1. Regjistri funksionon si një bazë e të dhënave në të cilën ruhen të gjitha dosjet unike të personalizuar për secilin person të regjistruar.

## Neni 20

### Dosja unike e personalizuar

1. Dosja unike e personalizuar e personit që rregjistrohet përbëhet nga 3 formularë, përkatësisht nga formulari A, B dhe C:
  2. Formulari A, përmban dhëna personale për të dënuarin, si vijon:
    - a) emri;
    - b) atësia;
    - c) mbiemri;
    - d) datëlindja;
    - e) vendlindja;
    - f) kombësia;
    - g) shtetësia;
    - h) numri personal i identitetit;
    - i) fotokopje e kartës së identitetit dhe e pasaportës;
    - j) statusi civil;
    - k) vendbanimi i përhershëm;
    - l) vendbanimi i përkohshëm;
    - m) vendbanimin e fundit;
    - n) numer telefoni;
    - o) adresa e postes elektronike;
    - p) të dhënat e përgjithshme të profilit të rrjeteve sociale;
    - q) të dhënat e kontaktit të personit më të afërt;
    - r) përshkrim i përgjithshëm i pamjes fizike, karakteristikat dhe çdo shenjë identifikuese;
    - s) fotografi aktuale;
    - t) shënjat e gishtërinjëve;
    - u) fotokopje e lejes së drejtimit;
    - v) numrin e targës së makinës, modelin, llojin e strukturës, vitin e prodhimit dhe ngjyrën e mjeteve motorike që janë të regjistruar në emrin e personit të dënuar;
  2. Formulari B, përmban të dhëna lidhur me punësimin apo angazhimet e të dënuarit, si vijon:
    - a) emri i punëdhënësit;
    - b) vendi e punës;
    - c) përshkrimi i përgjithshëm të punës;
    - d) datën e fillimit të punës;
    - e) kohëzgjatjen, kur palët lidhin kontratë me afat të caktuar;
    - f) kohëzgjatjen e pushimeve të paguara;
    - g) afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës;
    - h) elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj;



3. Formulari C, përmban të dhëna/informacione lidhur me historinë penale-gjyqësore të të dënuarit, si vijon:
- vepra/t penale për të cilën është dënuar;
  - fotokopje të vendimeve gjyqësore-penale;
  - data dhe detajet e të gjitha arrestimeve;
  - kohëzgjatja e dënimeve, data e përfundimit të vuajtjes së dënimit me burgim, lirimi;
  - statusi i lirit, me kusht, me provë, me mbikëqyrje;
  - identifikimi i viktimës së veprës penale;

#### Neni 21

##### **Forma dhe kohezgjatja e ruajtjes së Regjistrit**

- Regjistri ruhet në formë fizike dhe të dixhitalizuar/elektronike.
- Të dhënat dhe informacionet e regjistruara në Regjister ruhen pa afat edhe pas daljes nga regjistri të personit të dënuar për krime seksuale në arkivin e Regjistrit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

#### Neni 22

##### **Numri i dosjes**

- Numri i dosjes unike të personalizuar është numri unik i papërsëritshëm, që i caktohet çdo personi të dënuar për krime seksuale.
- Mënyra e formimit të këtij numri përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.

#### KREU V

##### **REGJISTRIMI, VETËDEKLARIMI DHE NJOFTIMI**

#### Neni 23

##### **Hyrja në regjister**

- Çdo person i dënuar për krime seksuale me vendim gjykate të formës së prerë, rregjistrohet në Regjister brenda 60 ditëve nga data e marrjes së vendimit.
- Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në të cilin personi i dënuar për krime seksuale do të vuajë dënimin penal brenda 30 ditëve nga fillimi i vuajtjes së dënimit informon me shkrësë zyrtare Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Nëse personi përgjegjës në IEVP nuk informon sipas ligjit DPPSh brenda 30 ditëve nga fillimi i vuajtjes së dënimit, ndaj tij fillojnë hetimet kryesisht nga prokuroria për veprën penale të Shpërdorimit të Detyrës.
- Personi përgjegjës në DPPSh për regjistrimin e personave në Regjister duhet të realizojë regjistrimin sipas ligjit të personit të dënuar brenda 30 ditëve nga marrja e informacionit nga IEVP-ja.

5. Nëse brenda 30 ditëve nga marrja e informacionit me shkresë zyrtare nga IEVP-ja përkatëse autoriteti përgjegjës për regjistrimin i DPPSh nuk rregjistron personin e dënuar për krime seksuale, ndaj tij fillojnë hetimet kryesisht nga prokuroria për veprën penale të Shperdorimit të Detyrës.

#### Neni 24

##### **Njoftimi i të dënuarit**

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit brenda 10 ditëve nga dita e regjistrimit në Regjister të personit të dënuar për krime seksuale e njofton atë me shkresë zyrtare në IEVP në të cilën personi i regjistruar vuan dënimin.

#### Neni 25

##### **Masat për periudhën e lejes**

Në rast të miratimit të lejes shpërblyese për personat e dënuar për krime seksuale Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve njofton së paku 5 ditë para miratimit të lejes Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me shkresë zyrtare.

#### Neni 26

##### **Aksesi në Regjister**

Të dhënat që ndodhen në Regjister mund të aksesohen vetëm nga institucionet publike dhe private që punojnë me / për fëmijët dhe që sipas ligjit kanë për detyrë të mbrojnë fëmijët.

#### Neni 27

Çdo institucion, publik ose privat, që punon me / për fëmijët në rast të emërimeve, rekrutimeve të personelit dhe në çdo rast tjetër të fillimit ose/ dhe vazhimit të marrëdhënieve të punësimit ka detyrim t'i drejtohet paraprakisht me kërkesë të arsyetuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për ti kërkuar informacion lidhur me regjistrimin opo jo të personave që kërkon të punësojë ose /dhe të mbajë të punësuar në bazën e të dhënave të Regjistrit.

#### Neni 28

Informacioni i lëshuar nga DPPSh specifikon vetëm nëse personi rezulton të jetë apo jo i regjistruar në Regjister.

#### Neni 29

1. Çdo person që për shkak të aksesit të tij në Regjister merr dijeni mbi regjistrimin apo jo të një personi të caktuar ose merr dijeni për të dhënat personale apo të dhëna të tjera që gjenden në dosjen unike të personalizuar të një personi të regjistruar, ka detyrimin ligjor ti trajtojë dhe administrojë këto të dhëna sipas kërkesave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2. Përhapja e çdo informacioni mbi këto të dhëna pa qenë i autorizuar për përhapjen e tyre përbën kundërvajtje penale dhe dënohet sipas nenit 122 të Kodit Penal.

#### Neni 30

##### **Akresi për qëllime të drejtësisë**

Prokuroria dhe organet e tjera ligjzbatuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kanë të drejtë t'i kërkojnë në çdo kohë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit informacione me qëllim hetimin dhe parandalimin e krimeve seksuale.

#### Neni 31

Në kërkesën për marrje informacioni që i drejtohet DPPSh, subjekti kërkues duhet të përcaktojë:

- a) qëllimin;
- b) lidhjen e drejtëpërdrejtë të objektit të veprimtarisë së tij me hetimin dhe parandalimin e krimeve seksuale;
- c) mënyrën sesi do të ruajë dhe arkivojë informacionin.

#### Neni 32

##### **Detyrimi për verifikim**

Çdo institucion publik ose privat përpara se të emërojë, rekrutojë personel ose të fillojë çdo marrëdhënie punësimi, ka detyrim të kërkojë verifikim tek autoriteti përgjegjës nëse kandidati që ka shprehur interesin për pozicionin e shpallur vakant figuron opo jo i regjistruar në Regjister, për punësimin si:

- a) Mësues dhe punonjës në sistemin arsimor në çdo nivel të sistemit parauniversitar;
- b) Kujdestar ligjor, jo prind, i një fëmije sipas vendimit të Gjykatës;
- c) Punonjës të institucioneve të përkujdesit dhe ofrimit të shërbimeve dhe përkujdesjes sociale për fëmijë në qendra rezidenciale, familje kujdestare, institucione fetare, institucione kulturore për fëmijë, qendra trajnimi dhe sporti për fëmijë;
- d) si dhe në çdo marrëdhënie punësimi veprimtaria e të cilës ka lidhje me fëmijët.

#### KREU VI

##### **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PERSONAVE TË REGJISTRUAR NË REGJISTËR**

#### Neni 33

##### **Të drejtat e të dënuarit për krime seksuale**

Personi i dënuar për krime seksuale i regjistruar në Regjister, ka të drejtë:

- a) të kërkojë në çdo kohë me kërkesë të motivuar, një kopje të dosjes unike personale të tij që gjendet në Regjister;
- b) të kërkojë në çdo kohë me kërkesë të motivuar letrën e kostentit;
- c) të përfitojë shërbime nga programet sociale të rehabilitimit dhe riintegrit;
- d) të kërkojë leje-autorizim autoritetit përgjegjës për lëvizje jashtë qytetit të banimit ose jashtë territorit të Shqipërisë ndërqytetase;
- e) të kërkojë korigjimin e gabimeve të bëra gjatë përpunimit të të dhënave administrative;
- f) ti drejtohet Gjykatës kompetente për të ankimuar regjistrimin e tij në Regjister kur pretendon se regjistrimi është i parregullt ose në kundërshtim me ligjin;
- g) ti drejtohet Gjykatës kompetente për fshirjen e emrit të tij nga Regjistri si person i regjistruar për krime seksuale me status aktiv pasi ka përmbushur kushtet e parashikuara për t'u konsideruar i padënuar sipas institutit të rehabilitimit të parashikuar në Kodin Penal.

#### Neni 34

##### **E drejta për deklaram vullnetar të prirjeve për të kryer abuzime seksuale**

1. Çdo individ që e percepton veten si person me prirje pedofilie ose ndjen se ka prirje për të kryer abuzime seksuale në çdo kohë ka të drejtë të deklarojë vullnetarisht para pikës më të afërt të kontaktit me policinë prirjet e tij pedofilike.
2. Personi përgjegjës i pikës më të afërt të kontaktit me policinë pranë të cilit paraqitet për vetëdeklarim individ që e percepton vetën si person me prirje pedofilike ose ndjen se ka prirje të kryejë abuzime seksuale shënon me kujdes në një procesverbal të gjitha të dhënat për aq sa ai mund të mbledh, sipas formularit A, B,C të parashikuar në nenin 20 të këtij ligji.
3. Brenda 10 ditëve nga mbledhja e të dhënave, personi përgjegjës i pikës më të afërt të kontaktit me policinë i dërgon një kopje të procesverbalit autoritetit përgjegjës në DPPSh.
4. Personat që deklarojnë vullnetarisht perceptimet e tyre për prirje pedofilie ose për të kryer abuzime seksuale përfitojnë trajnime dhe shërbime falas nga programet e rehabilitimit dhe riintegrit të ofruara autoritetet përgjegjëse me mbështetjen e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.
5. Procedura, mënyra e deklarimit vullnetar të individëve që e perceptojnë veten si persona me prirje për të kryer abuzime seksuale, si dhe procedura e regjistrimit të tyre në Regjister përcaktohen me vendim të titullarit të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

#### Neni 35

##### **Rehabilitimi dhe integrimi i personave të dënuar për krime seksuale**

1. Trajnimi i personave të dënuar për krime seksuale synon rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike.

2. Përgatitja për riintegrim fillon në paraburgim, vazhdon gjatë kryerjes së dënimit dhe pas lirimit nga burgu sipas ligjit Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve.

#### Neni 36

##### **E drejta e kërkesës dhe ankimit**

1. Personat e regjistruar në Regjister kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe të bëjnë ankime lidhur me zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore në formën që përcaktohet në këtë ligj apo aktet nënligjore përkatëse dhe në mënyrë individuale.
2. Kërkesat dhe ankesat duhet t'i drejtohen, si rregull, organit kompetent sipas këtij ligji, por personat e regjistruar kur e çmojnë me vend mund t'i drejtohen cilitdo organ shtetëror ose organizatë joqeveritare brenda dhe jashtë vendit.

#### Neni 37

##### **Detyrimet e të dënuarit**

I dënuari i regjistruar në Regjister, ka detyrim:

- a) të deklarojë të dhënat dhe të bashkëpunojë me autoritetet përgjegjëse për dhënien e çdo informacioni në kuadër të regjistrimit të tij në Regjister;
- b) të mos kryejë lëvizje ndërqytetase ose jashtë shtetit për asnjë arsye, përveç rasteve urgjente pa marrë më parë leje me shkrim nga autoriteti përgjegjës në DPPSh, leje e cila i jepet në dorëzim personit të dënuar për krime seksuale nga oficeri i pikës më të afërt të kontaktit të policisë;
- c) të respektojë detyrimet ligjore që burojnë nga regjistrimi në Regjister dhe të mbajë komunikim të vazhdueshëm me pikën më të afërt të kontaktit me policinë ku ai/ajo banon;

#### Neni 38

##### **Kërkesa për leje-autorizim**

1. Personi i dënuar për krime seksuale për periudhën në të cilën figuron i regjistruar në Regjister ka detyrim që përpara se të lëvizë jashtë qytetit në të cilin ai banon ose jashtë shtetit ti kërkojë leje-autorizim oficerit të pikës së kontaktit më afërt të policisë ku ai banon.
2. Në rast udhëtimi nga qyteti në të cilin banon në një qytet tjetër të Shqipërisë, personi i regjistruar në Regjister duhet ti kërkojë leje-autorizim jo më pak se 5 ditë përpara datës së udhëtimit, oficerit të pikës së kontaktit më afërt të policisë ku ai banon.
3. Në rast udhëtimi jashtë shtetit, personi i regjistruar në Regjister duhet të kërkojë leje-autorizim, jo më pak se 15 ditë përpara datës së udhëtimit.
4. Në kërkesën për leje-autorizim personi i regjistruar duhet të përshkruajë me hollësi:
  - a) datën e nisjes së udhëtimit;
  - b) vendin në të cilin dëshiron të mbërrijë;
  - c) adresën e shtëpisë/ hotelit të vendbanimit dhe kohëzgjatjen e qëndrimit;
  - d) arsyen e udhëtimit;

- e) numrin e telefonit që do të disponojë në vendin në të cilin dëshiron të mbërrijë;
  - f) numrin e telefonit të personit/familjarit pritës;
  - g) personat që dëshiron të takojë;
  - h) datën e kthimit në vendin e banimit.
5. Bashkëlidhur me kërkesën për leje-autorizim person i regjistruar në Regjister duhet ti dërgojë oficerit të pikës më të afërt të kontaktit edhe nga një kopje të biletës së udhëtimit dhe të fletë-rezervimit të hotelit ku do të qëndrojë.

KREU VII  
AFATET KOHORE TË QËNDRIMIT DHE DALJES NGA REGJISTRI

Neni 39  
**Kohëzgjatja e regjistrimit dhe dalja nga regjistri**

1. Regjistrimi i personit të dënuar për krime seksuale në Regjister zgjat deri në datën kur personi i dënuar për krime seksuale përfundon periudhën e rehabilitimit dhe që sipas nenit 69 të Kodit Penal quhet i padënuar.
2. Personi i dënuar për krime seksuale i regjistruar në Regjister në momentin që përfundon periudhën e rehabilitimit dhe që sipas nenit 69 të Kodit Penal quhet i padënuar ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës kompetente për të kërkuar heqjen e tij nga Regjistri.

KREU VIII  
SANKSIONET

Neni 40

1. Mos respektimi i detyrimeve ligjore që burojnë nga regjistrimi në Regjister nga personi i dënuar për krime seksuale, për aq kohë sa nuk përbën veper penale konsiderohen shkelje administrative dhe ndëshkohen më poshtë:
  - a) Në rast të shkeljes së detyrimit të parashikuar në germen a të nenit 37 të këtij ligji, ndëshkohet me gjobë nga 500 mijë lekë deri në 1 milion lekë;
  - b) Në rast të shkeljes së detyrimit të parashikuar në germen b të nenit 37 të këtij ligji, ndëshkohet me heqje të drejtës për të lëvizur jashtë qytetit të banimit nga 6 deri në 12 muaj;
  - c) Në rast të shkeljes së detyrimit të parashikuar në germen c të nenit 37 të këtij ligji, sipas rastit ndëshkohet me gjobë nga 300 mijë deri në 700 mijë lekë.
2. Në rast të përsëritjes së shkeljeve administrative të parashikuara më lart nga personi i dënuar për krime seksuale, për aq kohë sa nuk përbën veper penale konsiderohen shkelje administrative dhe masa e ndëshkimit vijon përkatësisht nga maksimumi i parashikuar për shkeljen e parë deri në dyfishim të masës ndëshkimore.

KREU IX  
DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 41

**Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë listën e profesioneve, veprimtaria e të cilave ka objekt punën me apo për fëmijët, brenda 3 muajve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare të këtij ligji.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të miratojë në bazë dhe për zbatim të këtij ligji rregulloren për organizimin dhe funksionimit e sistemit të të dhënave të Regjistrit si dhe aktet e tjera nënligjore të nevojshme për implementimin e këtij ligji, brenda 3 muajve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare të këtij ligji.
3. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë të dërgojë me shkresë zyrtare Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit listen e personave të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për krime seksuale përpara miratimit të këtij ligji, veprat penale të të cilëve nuk janë parashkruar, si dhe aktet e tjera nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij ligji, brenda 3 muajve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare të këtij ligji.

Neni 42

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.